

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 339, Datë 23.12.2025

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PROSOL” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2609/14 prot., datë 19.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “PROSOL” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609 prot., datë 10.10.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet 21 MW, me vendodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 259, datë 21.10.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.10.2025 dhe 23.10.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 21.11.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2609/3 prot., datë 27.10.2025, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.
- Me shkresën nr. 2609/5 prot., datë 21.10.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka njoftuar për zhvillimin e një seance dëgjimore me qëllim sqarimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancën e datës 03.11.2025, nga ana e përfaqësuesit të shoqërisë u mor angazhimi për të depozituar në ERE informacionin/dokumentacionin e munguar. Ky detyrim i është rikujtuar shoqërisë nga ERE, edhe nëpërmjet e-mailit të datës 2609/7 prot., datë 20.11.2025.
- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609/8 prot., datë 20.11.2025, shoqëria ka dhënë shpjegimet përkatëse në lidhje me kapacitetin, i cili do të jetë 21 MW ose 20 MW, por shoqëria është shprehur se aktualisht projekti i zbatimit është në proces dhe në rast se do të ketë ndonjë ndryshim në kapacitetin e instaluar (pa kaluar fuqinë 21 MW) do të marrë pëlqimin dhe miratimin e MIE-s sipas nenit 3.2 të kontratës.
- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609/10 prot., datë 27.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga analizimi i të cilit, u vlerësua i nevojshëm zhvillimi i një komunikimi të mëtejshëm me qëllim sqarimin e dokumentacionit/informacionit në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit, mbështetjen financiare dhe datën e parashikuar të fillimit të operimit, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën 2609/11 prot., datë 02.12.2025.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2609/12 prot., datë 12.12.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, si dhe ka paraqitur një argumentim teknik në lidhje me kapacitetin e centralit, ku 21 MWp që konvertohet në 20 MW AC. Po ashtu, shoqëria ka bërë me dije se do t'i drejtohet MIE-s për të marrë miratimin/pëlqimin e saj, ku do të vendosë dhe ERE-n në dijeni, ka kërkuar që të merret në konsideratë data 31.12.2025 për kthimin e përgjigjes nga MIE. Në vijim, ajo ka depozituar shkresën e saj të datës 16.12.2025, drejtuar MIE-s, për dijeni ERE, të protokolluar në ERE me nr. 2609/13 prot., datë 18.12.2025, me anë të së cilës ka kërkuar sqarimin përkatës në lidhje me fuqinë e instaluar të centralit fotovoltaike.

Zgjatja e vendimmarrjes së bordit

- Në nenin 14, pika 3, parashikohet se: *Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.*
- Për sa referuar nga vetë shoqëria se projekti i zbatimit është në proces, duke marrë në konsideratë detyrimet e saj për të bërë raportimet periodike në ministri për projektin e zbatimit dhe shkresën e saj drejtuar MIE-s në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar, vlerësohet e nevojshme zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e vendimmarrjes së bordit për aplikimin e saj, me qëllim depozitim në ERE të informacionit/dokumentacionit përkatës në lidhje me saktësimin e kapacitetit të instaluar të centralit. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin përkatës në lidhje me sqarimin e kapacitetit të instaluar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 21 MW, me vendndodhje në Fshatin Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacionin/dokumentacionin në lidhje me sqarimin e kapacitetit të instaluar të centralit.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “PROSOL” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI